



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE DIGJITALE

Nr. 8785 prot.

Himarë, më 05.12 . 2025

Lënda: Dërgohet për miratim projektvendimi “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2026”.

KESHILLIT BASHKIAK HIMARË,

Himarë

Në bazë të pikës 2, të nenit 8, pikës dh, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, si dhe në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Shërbimeve Digjitale dhe Drejtoria Juridike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë;

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Projektvendimin “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2026”.
- Relacion: Mbi projektvendimin “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2026”

KRYETARI

Vangjel Tavo

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËSKRYETARI

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE DIGJITALE

Nr. 8785/1 prot.

Himarë, më 05.12.2025

PROJEKTVENDIM

Nr. 65 datë, 05.12.2025

“PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2026”

Në bazë të pikës 2, të nenit 8, pikës dh, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, si dhe në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Shërbimeve Digjitale dhe Drejtoria Juridike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë;

VENDOSI:

1. Përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2026, për Bashkinë Himarë, i cili do të jetë 62 punonjës në total.
2. Nga këta 34 punonjës sezonal për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, 3 edukatorë kopshti zëvendësues ose ndihmës, 7 roje pyjesh sezonal, 6 roje zjarresh dhe 12 punonjës plazhi.
3. Pagesa do të bëhet bazuar në vendimin nr.28, datë 29.08.2024 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e niveleve të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë”.
4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2026.
5. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Shërbimeve Digjitale dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI**

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE DIGJITALE

Nr. 8785/2 prot.

Himarë, më 05.12.2025

RELACION:

MBI PROJEKTVENDIMIN “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2026”

Të nderuar Këshilltarë!

Në plotësim të nevojave që ka bashkia për mirëmbajtjen e territorit të saj gjatë sezonit turistik, mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarret gjatë stinëve të ngrohta të vitit, mbarëvajtjen e punës të institucioneve arsimore nën administrimin e Bashkisë Himarë dhe nevojave që dalin për mirëadministrimin e plazheve publike propozojmë që të shtohet forca punëtore sezonale duke punësuar përkatësisht: 3 edukatorë kopshti zëvendësues ose ndihmës, të cilët nevojiten për të zëvendësuar edukatorët të cilët marrin lejen e lindjes, si dhe edukatorë ndihmës për fëmijët me aftësi ndryshe 7 roje pyjesh sezonal, 6 roje zjarresh dhe 12 punonjës plazhi dhe 34 punonjës sezonal për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike.

Edukatorët zëvendësues ose ndihmës, rojet e pyjeve dhe rojet e zjarreve dhe punonjësit e plazhit do të emërohen nga Bashkia Himarë, kurse 34 punonjësit sezonal do të emërohen nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, e cila është në varësi të Bashkisë Himarë.

Këta punonjës do të emërohen sipas nevojave me kontratë të përkohshme në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Për sa më sipër numri total i punonjësve me kontratë pune të përkohshme, jashtë strukturës së bashkisë për vitin 2026, propozojmë të jetë 62 punonjës në total. Në mbështetje të kërkesave funksionale të Bashkisë Himarë dhe në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në nenin 54, pika dh të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, paraqitet për miratim numri i punonjësve sezonalë të nevojshëm për funksionimin normal të shërbimeve publike, institucionet arsimore nën administrimin e bashkisë, si dhe për menaxhimin e territorit dhe hapësirave publike gjatë vitit 2026.

Vlerësimi i nevojave është bërë duke marrë në konsideratë specifikat e territorit të Bashkisë Himarë, rritjen e ndjeshme të fluksit të popullsisë gjatë sezonit turistik, riskun e shtuar të zjarreve në zonat pyjore gjatë stinëve të ngrohta si edhe kërkesat e institucioneve arsimore për zëvendësimin e stafit të përkohshëm.

Gjatë sezonit të verës, Bashkia Himarë përballlet me rritje të shumëfishtë të popullsisë së përkohshme, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kërkesave për mirëmbajtje të territorit, pastrim të hapësirave publike, menaxhim të plazheve, kontroll dhe mbikëqyrje të zonave

pyjore, reagim të shpejtë ndaj rrezikut të zjarreve. Kjo rritje sezonale e kërkesave e bën të domosdoshëm angazhimin e stafit të përkohshëm.

Institucionet parashkollore nën administrimin e Bashkisë Himarë përballen me mungesa të përkohshme të stafit për shkak të lejeve të lindjes, nevojën për edukatorë ndihmës për fëmijët me aftësi ndryshe, garancinë e standardeve të kujdesit dhe mbikëqyrjes së fëmijëve. Për këtë arsye kërkohet shtimi i edukatorëve zëvendësues ose ndihmës.

Për shkak të temperaturave të larta gjatë verës dhe rritjes së aktivitetit njerëzor në zonat pyjore, rreziku i zjarreve rritet ndjeshëm. Për të garantuar monitorim dhe reagim të shpejtë kërkohet angazhim i rojeve të pyjeve dhe rojeve të zjarrit me kontratë të përkohshme.

Bazuar në nevojat e mësipërme, propozohet angazhimi i 62 punonjësve sezonalë, të shpërndarë si vijon:

- Edukatorë kopshti (zëvendësues ose ndihmës) – 3

Për të mbuluar mungesat për shkak të lejeve të lindjes.
Për të garantuar asistencë për fëmijët me aftësi ndryshe.

- Roje pyjesh sezonalë – 7

Për monitorimin e sipërfaqeve pyjore gjatë sezonit të nxehtë.
Për parandalimin e dëmtimeve dhe shkeljeve.

- Roje zjarresh – 6

Për reagim të menjëhershëm në rast rreziku.
Për monitorim të perimetrit pyjor dhe zonave të ekspozuara.

- Punonjës plazhi – 12

Për administrimin e hapësirave publike bregdetare.
Për garantimin e rendit dhe pastërtisë në zonat e plazhit.

- ❖ Shuma e punonjësve të emëruar nga Bashkia Himarë: 28

- Punonjës të emëruar nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike

Punonjës sezonalë për mirëmbajtjen e territorit dhe shërbimeve publike – 34

Për pastrimin e territorit gjatë sezonit turistik.
Për mirëmbajtjen e infrastrukturës publike.
Për menaxhimin e fluksit të mbetjeve dhe shërbimeve të tjera komunale.

- ❖ Shuma e punonjësve të emëruar nga NShP: 34

Numri total i punonjësve sezonalë të propozuar për vitin 2026: 62 punonjës

Këta punonjës do të angazhohen me kontrata të përkohshme pune, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Duke vlerësuar nevojat e rritura të bashkisë gjatë sezonit turistik, detyrimet për administrimin e territorit, pyjeve dhe plazheve publike, domosdoshmërinë për të garantuar funksionimin e institucioneve arsimore, dhe kapacitetet operative të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, propozohet miratimi i angazhimit të 62 punonjësve sezonalë jashtë strukturës së Bashkisë Himarë për vitin 2026.

Për të gjitha arsyet e mësipërme, vlerësojmë se miratimi i kësaj strukture sezonale është i domosdoshëm, pasi ajo shërben si përgjigje ndaj nevojave reale të strukturës vendore, detyrimeve ligjore, si edhe ngarkesës së shtuar të punës që vjen jo vetëm nga zgjerimi i funksioneve bashkiake, por edhe nga specifikat territoriale dhe sezonaliteti i lartë turistik.

Në këto kushte, kërkojmë miratimin e këtij projektvendimi nga Këshilli i Bashkisë Himarë, duke theksuar gjithashtu gatishmërinë për të reflektuar çdo propozim për ndryshim apo plotësim të kësaj strukture nga ju, të nderuar këshilltarë.

DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Muhametaj



DREJTORIA E DBNJISHD

Ergis Papaproko

